

KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE
"A R D O" S H P K

ARBEN ISMAILAGA i biri i Xhevatit, dhe i Dylberes, lindur ne Tirane ne 1960 dhe banues ne Tirane ne rrugen Sh. Jegeni Nr.1 dhe **ARMANDO DUKA**, i biri i Enverit dhe i Vajes, lindur nr Shijak ne 1962 e banues po ne Shijak ne Lagjen "Popullore" kane rene dakort qe te krijojne nje Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar konform vullnetit te tyre te lire dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar", si dhe ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private dhe privatizimit " si me poshte:

Neni 1

Te themeloje nje Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtari ekonomike e emertuar: "ARDO" sh p k .

Kjo Shoqeri Tregtare do ta kete seline e saj ne Tirane ne rrugen Qemal Stafa Nr.347 si dhe ne Shijak ne Lagjen "Popullore" dhe do te zhvilloje veprimtari ekonomike per nje periudhe deri ne vitin 2000 me te drejte riperteritje.

Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar , Shoqeria Tregtare "ARDO" sh p k eshte person juridik shqiptar dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, nga normat e parashikuara ne kete kontrate si dhe statutit qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

Shoqeria pergjigjet ne marredhenit me te tretet vetem me fondet e veta dhe ortakët pergjigjen vetem per detyrimet e kesaj Shoqerie.

Neni 3

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise Tregtare "ARDO" sh p k do te jete:

- Veprimtari tregtare per tregtimin e mallrave te ndryshme si mallra industriale, mallra te konsumit te gjere, elektroshtepiake, mallra ushqimore, bujqesore e blegtorale, bime medicinale e eterovajore, lende te para e gjysem te gateshme etj, me pakice e me shumice si dhe import e eksport te te gjitha llojeve e ne te gjitha drejtimet.

Neni 4

KAPITALI THEMELTAR i Shoqerise do te jete 1 000 000 leke. Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e ndare ne 1000 leke.

Kapitali ndahet si me poshte :

Arben Ismailaga ka pjeset qe fillojne nga numri i serise 1 deri ne numrin e serise 60; dhe

Armando Duka ka pjeset qe fillojne nga numri i serise 61 deri ne numrin e serise 100.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise sipas nenit 4 te kesaj kontrate, perfaqeson kapitalin e derdhur nga Ortaket, te nevojshem per veprimtarine e Shoqerise .Sipas kerkeses se Ligjes Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje nga Bankat e Shtetit Shqiptar ose ne nje nga Bankat e tjera qe jane hapur ose do te hapen ne te ardhmen ne Shqiperi, te njohura nga

shteti shqiptar.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregtare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortaket. Rritja e kapitalit te ortakeve nuk eshte e kufizuar.

Neni 6

Shoqeria vazhdon veprimtarine e saj ne baze te rregjistrimit si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Tirane si dhe rregjistrimin e saj po ne kete Gjykate ne rregjistrin tregtar.

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga Ortaket.

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e Shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet, eshte plotesisht i transferueshem per tu depozituar ne nje nga Bankat jashte Shqiperise.

Neni 7

ORGANET DREJTUESE SE SHOQERISE JANE:

-ASAMBLEJA E ORTAKEVE;

-ADMINISTRATORI

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga statuti i Shoqerise.

Neni 8

ASAMBLEJA E ORTAKEVE ose ADMINISTRATORI eshte pergjegjes per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit per Shoqerite Tregtare.

Neni 9

VLEFSHMERIA E KONTRATES:

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe deri ne vitin 2000.

Asambleja e Ortakeve vendos ne cdo kohe mbylljen ose zgjatjen e afatit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarreshjeve midis Ortakeve dhe personave te trete do te behet konform normave te konventave nderkombetare per rregullimin e mosmarreshjeve ne Shoqerite Tregtare, ne Gjykaten e Rrethit Tirane ose ne nje Gjykate Nderkombetare.

Neni 11

Dispozitat me te detajuara per Shoqerine Tregtare "ARDO" sh p k, jane te percaktuara dhe permbahen ne Statutin e saj.

Neni 12

Kjo kontrate formulohet ne kater kopje nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise ne Tirane, njera depozitohet ne Gjykaten e Rrethit Tirane, njera ne Zyren e Tatimeve dhe kopja e kater mbahet ne dokumentat e Shoqerise.

Kjo kontrate eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimit te saj nga Ortaku i Vetem.

O R T A K E T

Arben Ismailaga

Armando Duka

Tirane me . 03.1994

STATUT

I

SHOQERISE TREGTARE "A R D O " SH P K

Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar " ARDO" sh p k ,eshte krijuar sipas kontrates per themelimin e saj nga ortaket Arben Ismailaga dhe Armando Duka.

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj Shoqerie ne perputhje me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar",eshte perpiluar ky Statut me kerkesat e Ligjes per Shoqerite Tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

(forma, emertimi, objekti, selia, kohezgjatja)

Neni 1

Ortaket e lartepemendur pjesemarrës ne Kontraten e Themelimit kane krijuar nje Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria Tregtare e ka fituar te drejten e personit juridik me rregjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane si dhe rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar.

Neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE TREGTARE eshte "ARDO" SH P K dhe ka si objekt te saj:

VEPRIMTARI TREGTARE PER TREGTIMIN E MALLRAVE TE NDRYSHME SI;MALLRA INDUSTRIALE,MALLRA TE KONSUMIT TE GJERE,ELEKTROSHTEPIAKE,MALLRA USHQIMORE,BUJQESORE E BLEGTORALE,BIME MEDICINALE E ETEROVAJORE,LENDE TE PARA E GJYSEM TE GATESHME ETJ,ME PAKICE E ME SHUMICE SI DHE IMPORT E EKSPORT TE TE GJITHA LLOJEVE E NE TE GJITHA DREJTIMET.

SELIA E SHOQERISE TREGTARE eshte ne Tirane ne rrugen Qemal Stafa nr.347 dhe ne Shijak Lagja Popullore.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE TREGTARE eshte parashikuar per nje periudhe deri ne vitin 2000 me te drejte ripërteritje.

KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE TREGTARE eshte 1 000 000 leke.

Neni 3

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese me nje vlefte per sejcilen pjese 10 000 leke,te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100 krejtesisht te shlyeshme.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj.

Zmadhimi ose zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga Asambleja e Ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen tek te tretet vetem pas miratimit nga Ortaku i mbetur por jo me nje vlere me te ulet se ajo e propozuar nga ai.

KREU I DYTE ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 4

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Sejcili Ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese. Ajo vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin dhe paksimin e kapitalit themeltar, per emerime e shkarkime te administratorit, per emerimin e eksperteve kontabel, per pushimin, per hapjen e degeve, perfaqesive dhe filialeve ne rrethet e tjera, per transferimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per zgjatjen e afatit etj.

Neni 5

Vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve ne mbledhjet e zakonshme e te jashtezakonshme, ne perputhja me kete Statut, jane te detyrueshme e te zbatueshme per sejcilin Ortak.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda kater muajve nga mbyllja e veprimtarive ekonomike te Shoqerise.

Neni 6

Shoqeria administrohet nga **ORTAKU ARBEN ISMAILAGA**.

Ne marredheniet me te tretet administratori i ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj, qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise.

Neni 7

Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Asambleja e Ortakeve.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe ben te pamundur kryerjen e detyres.

Neni 8

Per punonjesit qe do te punesohen ne Shoqerine Tregtare do te zbatohen aktet ligjore dhe nenligjore te dale per kete qellim duke lidhur kontratat e punes me sejcilin per nje afat jo me shume se periudhe 1 vjecare.

Paga e punes nuk eshte e kufizuar por ajo nuk mund te jete me e ulet se ajo e percaktuar me vendime te vecanta te Qeverise.

KREU I TRETE
MARREDHENIET EKONOMIKO FINANCIARE

Neni 9

Viti financiar fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore ,inventari,raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga ekspertit kontabel i autorizuar ,miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

Miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 10

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit ,**ASAMBLEJA E ORTAKEVE** percakton pjesen qe i takon mbi fitimin,te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem(jo me pak se 1/20 e fitimit te cdo viti,deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 te kapitalit themeltar)si dhe te jene zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 11

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi ne leke ose ne valute te huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

Neni 12

Shoqeria Tregtare me qellim qe ta beje sa me te lehte dhe me te shpejte pagesat me te tretet do te hape nje llogari bankare ne nje nga Bankat qe jane te njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose te huaj.

KAPITULLI I KATERT
ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 13

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit ,zgjatja e tij behet vetem me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Ajo priset kur mbaron afati i percaktuar dhe Ortaket nuk kane rene dakort qe te bejne ripertesitjen e ketij afati.

Shoqeria mund te shndrohet ne nje nga format e percaktuara nga ligji dhe ne formen e kerkuar nga ligji.

Neni 14

Shoqeria Tregtare hyne ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Asambleja e Ortakeve emeron nje likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit te pasivitetit te Shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshmem per perfundimin e tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve, vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsin e likujdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te Shoqerise.

Neni 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin ndermjet Ortakeve ose ne marrredheniet me te tretet, gjate ekzekutimit te ketij statuti dhe kontrates se themelimit gjate ekzistences se Shoqerise si gjate kryerjes se veprimtarise ashtu dhe ne procesin e likujdimit do ti drejtohen per gjykim Gjykates se Rrethit Tirane ose ndonje Gjykate nderkombetare.

Neni 16

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje, njera kopje depozitohet ne Zyren e Noterise ne Tirane, njera ne Gjykatën e Rrethit Tirane, njera ne zyren e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet ne dokumentat e krijimit te Shoqerise.

O R T A K E T

ARBEN ISMAILAGA

ARMANDO DUKA

Tirane me .03.1994

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A

Nr. Rep
Nr. Kol.

V E R T E T I M

Sot ne daten .03.1994, ne zyren e noterise ne Tirane u paraqiten personalisht para meje Noteres Ortaket e Shoqerise Tregtare "ARDO" sh p k ARBEN ISMAILAGA dhe ARMANDO DUKA, per identitetin e te cileve u vura ne dijeni nga leternjoftimet qe ata mbajne me vete, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se kete kontrate e statut pasi e lexuan e nenshkruan rregullisht me vullnetin e tyre te lire, cka e vertetoj une si Notere me nenshkrimin tim.

N O T E R E
Shpresa Spahiu